



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 42/2 Prot.

Tiranë, më 17/2/2010

**Lënda:** Rekomandim për "Savatours" Sh.p.k.

**REKOMANDIM**

Nr. 42/2, datë 17/2/2010

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, A "Savatours" Sh.p.k.

**KONSTATOVA**

Më datë 13.09.2010 deri 14.10.2010 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, "Savatours" Sh.p.k. me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë, punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kritereve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1- Kontrolluesi, Agjencia “Sava Tours”, në zbatim të neneve 27/2 “c” dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” nuk është shprehur në ndonjë rregullore të brendshme të hartuar prej saj, lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale të klientëve.

- Nuk është zbatuar pika 2/c e nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... *“udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë ne përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave”...*
- Nuk është zbatuar neni 28 i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, *“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.*

2- Kontrolluesi Agjencia “Sava Tours”, Tiranë mbante në mënyrë manuale dhe automatike, gjithashtu bënte transferim ndërkombëtar të të dhënave personale të klientëve si, emër, mbiemër, numër telefoni, por pa siguruar *deklaratën specifike të dhënë (pëlqimin), e shprehur nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij.*

- Në këtë rast nuk është zbatuar pika 2/b e nenit 8 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, *Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet nëse; subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferimin ndërkombëtar;*
- Nuk respektohet pika 12 e nenit 3 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, *“Pëlqim” është deklarata specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij.”*



Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 3, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të hartohet rregullore ose të përfshihet në rregullore seksioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Gjithashtu të përfshihen rubrika në lidhje me dhënien e pëlqimit nga klientët për përpunimin e të dhënave të tyre personale nga kontrolluesi.
2. Në zbatim të neneve 3, 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” përmbushjen e detyrimit në lidhje me transferimet e të dhënave për klientët duke përmbushur detyrimet që parashikon ligji dhe konkretisht Udhëzimi nr.1, datë 19.02.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej dy muajsh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

